



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Protato Received/Delivered	15.06	2023	3	viti god year
Organ/Njësia Org./Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtypja Printig Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPM/SHCK	4744/2023		119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.693/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.693/2023 të datës 02.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ të cilin me autorizim e përfaqëson _____, me adresë: Rruga " _____ " e Prishtinës, kundër Vendimit Nr.705/5 të datës 27.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.693/2023 e datës 02.05.2022 e parashtruar nga ankuesi _____.
- II. Anulohet** Vendimi Nr.705/5 i datës 27.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, _____, i punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 02.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3978/2023 e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.693/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.705/5 të datës 27.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit dhe shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, inicimi i procedurës disiplinore nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, sikurse Vendimi i Këshillit A.nr.142/2023 i datës 15.03.2023 nuk është zbatuar, apo pikëpamjet e dhëna juridike të këtij vendimi janë interpretuar gabimisht, Komisioni Disiplinor përmes aktit të kontestuar në këtë procedurë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesit nuk i është dhënë mundësia e paraqitjes së provave dhe dhënies së deklaratave në seancë, sikurse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni Disiplinor ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe nuk është mbështetur me prova dhe fakte relevante.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 08.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa me datën 16.05.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër te protokollit 3978/2023 të datës 02.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës; Vendimi Nr.705/5 i datës 27.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.05.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 16.05.2023 me shifër:705/6; Shkresën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit të datës 03.04.2023 me shifër reference: DPKI-06-666/23; E-mailin e datës 14.04.2023 dërguar nga T.A për E.Z dhe B.S; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 18.04.2023; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 27.04.2023; E-mailin e ankuesit të datës 14.02.2022 drejtuar zv. Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë; E-mailin e ankuesit të datës 23.02.2022 drejtuar zv. Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; E-mailin e ankuesit të datës 13.05.2022 drejtuar për E.A nga Zyra e Sekretarit; E-mailin e ankuesit të datës 04.10.2022 drejtuar R.H; E-mailin e ankuesit të datës 04.08.2022 drejtuar për E.D; E-mailin e datës 31.08.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 12.09.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e ankuesit të datës 21.09.2022 drejtuar për M.Q; E-mailin e ankuesit të datës 29.09.2022 drejtuar për T.A; E-mailin e datës 10.11.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 21.11.2022 dërguar nga ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ankuesin; E-mailin e datës 30.11.2022 dërguar nga

ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për Sekretarin e Përgjithshëm; Njoftimin e datës 27.03.2023 dërguar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Këshillin; Kërkesën e datës 24.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm dërguar për Agjencinë për parandalimin e Korrupsionit; Vendimin e këshillit A.nr.142/2023 të datës 15.03.2023; Amendamentin e Kontratës Kornizë i datës 12.09.2023 me Referencë:14/01-21/17; Vendimin e datës 28.08.2017 me numër ref:41/17; Vendimin e datës 10.08.2017 me numër ref:36/17; E-mailin e datës 31.03.2023 dërguar nga F.M për Këshillin; E-mailin e datës 28.04.2023 dërguar nga F.M për Këshillin; Procesverbalin e datës 28.03.2023 të Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 07.04.2023 dërguar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Ankesën me numër te protokollit 748/2023 të datës 24.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor me numër 4262/4 e datës 29.12.2022; Inicimi i procedurës disiplinore me numër 4262 i datës 01.12.2022; Akt emërimi me numër 462 datës 20.02.2013; Autorizimi i datës 21.12.2022; Kopja e letërnjoftimit; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar H.S e datës 30.12.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga L.A drejtuar H.S e datës 17.01.2023; E-mail i dërguar nga F.P drejtuar B.H e datës 30.11.2022; E-mail i dërguar nga F.P drejtuar M.S dhe F.G e datës 21.11.2022; Vendim i lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm me numër 08/2 e datës 17.01.2023; Vendim për zgjedhjen e Komisionit Disiplinor me numër 4056 e datës 13.10.2020; E-mail i dërguar nga MBPZHR drejtuar B.H e datës 29.12.2022; E-mail i dërguar nga H.S drejtuar L.A e datës 20.01.2023; E-mail i dërguar nga L.A drejtuar H.S e datës 23.01.2023; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 28.12.2022; E-mail i dërguar nga M.S drejtuar F.G e datës 10.11.2022; E-mail dërguar nga F.G drejtuar B.S e datës 14.02.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar B.D e datës 23.02.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar M.Q e datës 21.09.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar E.D e datës 04.08.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar T.A e datës 29.09.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar R.H e datës 04.10.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar E.A e datës 13.05.2022; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar F.G e datës 12.09.2022; Vendimin i përkohshëm për punë shtesë i datës 29.08.2022; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar F.G e datës 31.08.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 03.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 01.03.2023; Shpalljen e Konkursit me numër ref.12 IBK- Pejë e datës 20.02.2010; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore me numër 4660 e datës 18.11.2020; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar F.G e datës 10.11.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar M.Q e datës 21.09.2022; E-mail i dërguar nga F.I drejtuar E.K e datës 13.12.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar E.K e datës 29.11.2022; E-mail i dërguar nga F.G drejtuar B.D e datës 23.02.2023; Ekstrakt i procesverbalit me numër 774 e datës 25.02.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 906 e datës 03.03.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 1473 e datës 08.04.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2019 e datës 27.05.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 3972 e datës 10.11.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2085 e datës 02.06.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2964 e datës 02.09.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2000 e datës 25.05.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 3972 e datës 10.11.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 525 e datës 10.02.2022; E-mail i dërgua nga T.A drejtuar F.G e datës 22.12.2022; E-mail i dërguar nga T.A drejtuar F.G dhe H.S e datës 23.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 12.12.2022; Procesverbal i takimit të

komisionit disiplinor i datës 22.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 23.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 28.12.2022; Ndryshim plotësimi i akt emërimit me numër 2043 i datës 06.07.2015; Akt emërim me numër 1841 i datës 11.05.2016; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit me numër 2209/8 i datës 12.07.2019; E-mail i dërguar nga T.A drejtuar F.M e datës 23.01.2023; Deklaratë e T.A datës 28.02.2023; Deklaratë e E.S datës 28.02.2023; Deklaratë e B.S datës 28.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____, është *e bazuar*, sepse:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 05.01.2015 është i punësuar në pozitën e punës *“Drejtor i Institutit Bujqësor të Kosovës- Pejë”* pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa pas kërkesës së Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sekretari i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 01.12.2022 kishte iniciuar procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës; shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; kryerja e përsëritur brenda dhe jashtë orarit zyrtar të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi si dhe shkelja e detyrave të përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Tutje, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes Vendimit me numër të protokollit 4262/4 të datës 29.12.2022 kishte konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të përcaktuara me nenin 45 paragrafi 1 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.6, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, paragrafi 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë si dhe nenit 5 paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores (QRK) – Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore *“Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen e shkallës së pagës për një periudhë nga dy deri në pesë vjetë përkatësisht në periudhë pesë (5) vite”*, kundër të cilit vendim ankuesi kishte parashtruar ankesë në Këshill me datë 24.01.2023.

Këshilli pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit me datë 15.03.2023 kishte nxjerrë Vendimin A.nr.142/2023 përmes të cilit ankesën e ankuesit të datës 24.01.2023 e kishte aprovuar për shkak të shkeljeve procedurale të bëra nga Komisioni Disiplinor, aktin e ankimuar, gjegjësisht Vendimit e datës 29.12.2022 të Komisionit Disiplinor e kishte shfuqizuar, ndërsa lëndën e kishte kthyer te Komisioni Disiplinor për ri-shqyrtim dhe rivendosje me përcaktim e qartë se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes për lëndën e ankuesit duhet t'i përmbahet pikëpamjeve juridike të dhëna nga Këshilli duke evituar shkeljet procedurale, sikurse arsyetimin e dhënë për konstatimin lidhur me shkeljet eventuale disiplinore duhet ta arsyetojë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me ligjin material.

Komisioni Disiplinor sipas arsyetimit të dhënë me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit A.nr.142/2023 të datës 15.03.2023, lidhur me lëndën e ankuesit ka rivendosur përmes Vendimit

- Nr.705/5 i datës 27.04.2023, e që në pikën 1 të dispozitiv të tij e lenë në fuqi vendimin paraprak me numër të protokollit 4262/4 të datës 29.12.2022 të Komisionit Disiplinor, vendim të cilin Këshilli e kishte shfuqizuar paraprakisht.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar përmbajtjen e Vendimit Nr.705/5 i datës 27.04.2023 të Komisionit Disiplinor, dhe ka gjetur se Komisioni Disiplinor ke vepruar në kundërshtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, gjegjësisht ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, ngase Komisioni Disiplinor përmes Vendimit Nr.705/5 të datës 27.04.2023 me arsyetimin se pas rishqyrtimit dhe rivendosjes lidhur me lëndën e ankuesit, e ka lënë në fuqi Vendimin Nr.4262/4 të datës 29.12.2022 të Komisionit Disiplinor, vendim i cili paraprakisht ishte shfuqizuar përmes Vendimit të Këshillit A.nr.142/2023 të datës 15.03.2023, ndërsa kujtojmë faktin se sipas nenit 22 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. 2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit”*, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative të përcaktuar me nenin 4 si në vijim: *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca”*, ngase sipas dispozitave të nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 11 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore.”* nga rrjedh se Komisioni Disiplinor nuk ka autoritet apo autorizim të rikthejë në fuqi një akt administrativ i cili është shfuqizuar nga organi epror përmes vendimit që në procedurë administrative është i formës së prerë, sikurse janë vendimet e Këshillit, madje në rastin konkret vendimi i Këshillit A.nr.142/2023 i datës 15.03.2023 ishte bërë i ekzekutueshëm.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar procesverbalet e seancave apo takimeve të Komisionit Disiplinor të mbajtura me datë 23.03.2023 ka gjetur se institucioni punëdhënës i ankuesit e kishte adresuar kërkesën e palës ankuese lidhur me konfliktin e interesit për njërin nga anëtarët e Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa nga shkresat e lëndës del që Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me datë 03.04.2023 e ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se në rastin konkret pjesëmarrja e zyrtarit T.A anëtar i Komisionit Disiplinor nuk ka konflikt interesi në shqyrtimin e kësaj lënde ne procedurë të iniciuar disiplinore .

Kolegji i Këshillit, ka gjetur se anëtarët e Komisionit Disiplinor me rastin e mbajtjes së seancës së datës 18.04.2023 njëzëri pajtohen dhe konstatojnë se nuk ka nevojë për ta kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje dhe njëkohësisht vendosin të mbesin prapa vendimit bazik të marrë nga

Komisioni Disiplinor i datës 29.12.2023, prandaj mbështetur mbi këtë konstatim sikurse arsyetimit të dhënë në vendimin e datës 27.04.2023 të kontestuar në këtë procedurë, Kolegji i Këshillit ka arritur në përfundimin se Komisionin Disiplinor ka shpërfillur obligimet ligjore që kanë rrjedhur nga Vendimi i Këshillit A.nr.142/2023 i datës 15.03.2023 dhe pikëpamjet juridike të tij, gjegjësisht organi i njëjtë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural më palët në procedurë administrative me qëllim të rishqyrtimit të lëndës së ankuesit, përveç adresimit të kërkesës së ankuesit për konflikt të interesit nga anëtari i komisionit disiplinor T.A.

Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimin KD.nr.01/2023 duke mos i ftuar në seancë palët në procedurë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore si dhe në kundërshtim edhe me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, pasi që përmes vendimit të Këshillit A.nr.142/2023 të datës 15.03.2023 kur ishte shfuqizuar vendimi paraprak i Komisionit Disiplinor i datës 29.12.2023 dhe lënda ishte kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje, gjegjësisht rasti ishte kthyer në pikën zero apo deri tek faza kur ishte iniciuar procedura disiplinore nga Sekretarin të Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 01.12.2022, gjegjësisht Komisioni Disiplinor sipas detyrës zyrtare kanë qenë të obliguar ta ftojnë në seancë Sekretarin e Përgjithshëm në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore sikurse edhe ankuesin në cilës të palës ndaj të cilit ka qenë duke u zhvilluar procedura disiplinore, me qëllim që të njihen me variantin e tyre të ngjarjes apo problemit.

Po ashtu, neni 12 paragrafi 4 dhe 5 i Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore ka përcaktuar se: *"Seancat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 5. Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative"* ndërsa në kuptim të nenit 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet se: *"Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes. 95.1 Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t'u dëgjuar"*, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.705/5 të datës 27.04.2023 duke mos i ftuar në seancë palët në procedurë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore si dhe në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: *"1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes"*, ngase nga shkresat e lëndës nuk është vërejtur asnjë veprim procedural me qëllim të verifikimit të fakteve apo për verifikimin e ngjarjes, gjegjësisht ky veprim i Komisionit Disiplinor ia ka pamundësuar ankuesit të paraqet shpjegimin e fakteve,

rrethanave apo provat mbështetëse, duke ia përkeqësuar situatën juridike apo duke ia mohuar të drejtën për pjesëmarrje në cilësi të palës në procedurë administrative.

Kolegji i Këshillit me qëllim të mbështetjes së konstatimit të dhënë se pse është e rëndësishme dhe obligative që Komisioni Disiplinor zbatojë dispozitat e lartcekura ligjore sikurse edhe dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me qëllim të verifikimit të ngjarjes apo rrethanave tjera që ndërlidhjen me përcaktimin apo kualifikimin e shkeljes së supozuar dhe konstatimit të gjendjes faktike, po i ritheksojmë të paktën dy fakte apo situata, respektivisht sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës i datës 31.01.2023, ankuesi për vitin 2022 nga Sekretari i Përgjithshëm ishte vlerësuar me notën e përgjithshme 3.1 e cila në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 Për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: *"mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës*" prandaj në rastin konkret inicimi i procedurës disiplinore nga Sekretari i Përgjithshëm se ankuesi nuk i ka përmbushur detyrat e punës, sikurse edhe konstatimi i Komisionit Disiplinor se ankuesi ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, janë konstatime kundërtënëse prandaj pa pjesëmarrjen e palëve në procedurë dhe verifikimin e të gjitha shkresave apo dokumentacionit që ndërlidhet me rastin apo ngjarjen, Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj sakt gjendjen faktike nëse pretendimet e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit janë të qëndrueshme.

Po ashtu, lidhur me konstatimet e Komisionit Disiplinor se ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, përkatësisht ka shkelur dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Shkelje të rënda konsiderohen: 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil;"* dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të përmbush mandatin e tij ligjor, detyrat funksionale dhe përgjegjësit e përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë sikurse: *"Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura"* ngase termi *shkelje e përsëritur e rregullave dhe kryerje e përsëritur* të përcaktuara sipas dispozitave ligjore të lartcekura në mënyrë kumulative janë të verifikueshme vetëm nëse për të njëjtat shkelje, ka pasur paraprakisht një konstatim sipas kritereve të përcaktuara të këtij ligji, ngase Kolegji i Këshillit nga arsyetimi i dhënë në aktin e goditur me këtë ankesë, Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoi faktin nëse ankuesi në të kaluarën ka kryer shkelje disiplinore dhe për të njëjtat shkelje ka ndonjë masë aktive në fuqi, të shqiptuar qoftë nga Udhëheqësi i tij i Drejtpërdrejtë apo Komisioni Disiplinor, sikurse përcaktohet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik: *"1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji"*, respektivisht nëse për një çështje të tillë nuk ka vendim përfundimtar të konfirmuar se ankuesi ka kryer edhe në të kaluarën shkelje disiplinore, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor nuk mundet t'iu referohet këtyre dispozitave ligjore në rastin konkret, ngase të njëjtat norma përcaktojnë vetëm rastet e përsëritura dhe të konfirmuara përmes vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të cilat e kanë marrë formën e ekzekutueshmerisë në kuptim të nenit 144 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material në rastin konkret.

Këshilli me rastin e aprovimit të ankesës së ankuesit të datës 24.01.2023 përmes Vendimit A.nr.142/2023 të datës 15.03.2023, kur e kishte kthyer lëndën e ankuesit në ri-shqyrtim dhe rivendosje ia kishte tërhequr vërejtjen Komisionit Disiplinor që të evitoj shkeljet procedurale, arsyetimin e vendimit të marrë pas rivendosjes dhe rishqyrtimit ta nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse në vendimin e lartë cekur Kolegji i Këshillit i kishte sugjeruar Komisionin Disiplinor se arsyetimi i vendimit të marrë duhet të jetë i kuptueshëm dhe i qartë, duke marrë për bazë edhe interpretimin dhe përcaktimin e nenit 45 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarë Publikë ku përcaktohet se: *“1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmi”* e që në rastin konkret përmes nxjerrjes së Vendimit të datës 27.04.2023 duke shpërfillur veprimet e obligueshme procedurale, komisioni Disiplinor nuk ka arritur ta arsyetoj apo konstatojë këtë fakt dhe të ndërlihd veprimet e përgjegjësive disiplinore ndërmjet vete në mënyrë kumulative sikurse është përcaktuar me dispozitat e lartcekura.

Prandaj, duke marrë për bazë arsyetimin e dhënë si më lartë, ku është konstatuar se Komisioni Disiplinor përveç trajtimit ndaras të kërkesës për adresimin e konfliktit të interesit të mundshëm të anëtarit të Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, asnjërën prej pikëpamjeve juridike apo të gjeturave të Këshillit të dhëna përmes Vendimit A.nr.142/2022 nuk i ka respektuar, madje shkeljet procedurale dhe obligimet zyrtare që burojnë nga Kompetenca e Komisionit Disiplinor janë shkelur në mënyrë flagrante, gjegjësisht Vendimi Nr.705/5 i datës 27.04.2023 i Komisionit Disiplinor nuk e përmbush as elementin thelbësor të elementeve të detyrueshme të aktit administrativ sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *“Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit”* e që në rastin konkret vendimi i goditur me këtë ankesë në pikën 1 të dispozitiv ka lënë në fuqi apo rikthen në fuqi vendimin e shfuqizuar të datës 29.12.2022 të Komisionit Disiplinor, vendim të cilin Këshilli e kishte shfuqizuar përmes Vendimit A.nr.142/2022 të datës 15.03.2023 kur edhe e kishte kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje. Andaj, Kolegji thekson faktin se Këshilli nuk mund të bart barrën e përgjegjësive procedurale dhe lëshimeve të përsëritura të Komisionit Disiplinor dhe mbi këtë bazë nuk ka mundur të lëshohet në shqyrtimin e mëtejshëm të veprime të ankuesit, nëse të njëjtat paraqesin shkelje apo ajo, ngase Këshilli nuk ka mandat të shqiptojë masa disiplinore ndaj nëpunësve civil apo të përliq një procedurë të jashtëligjshme e cila prodhon një akt administrativ të paligjshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave të ligjit material dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa Vendimi Nr.705/5 i datës 27.04.2023 i Komisionit Disiplinor, është vendim i paligjshëm siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi

1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2 është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4 është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", dhe si i tillë Vendimi Nr.705/5 i datës 27.04.2023 i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar vetëm për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.693/2023**

Flakron GASHI



Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të palës ankuese, .
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.